

ANEKS – SPECIFIKIME TEKNIKE

PUBLIKIMI DHE KRONOLOGJIA E NGJARJEVE OPERATIVE

Faktike					Të Pritshme								
E Enjte	E Premte	E Shtunë	E Diel	E Hënë	E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte	E Shtunë	E Diel	E Hënë	E Martë	E Mërkurë
				E Hënë	E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte	E Shtunë	E Diel	E Hënë	E Martë	E Mërkurë

	Periudhë e Parashikuar		Dita e Shlyerjes së Ankandit Javor (Injektimi)
	Dita e Publikimit		Dita kur Niveli Mesatar i Likuiditetit Synohet të jetë Neutral
	Dita e Ankandit Javor		

Çdo të martë, Banka e Shqipërisë publikon pritjet e saj për nivelin mesatar të faktorëve autonomë (AF_t), nivelin mesatar të likuiditetit të patregtueshëm (NLT_t) gjatë periudhës së parashikuar, si dhe vlerën standarde të likuiditetit (M_t^{bench}) ose thënë ndryshe, vlerën e likuiditetit që do të ofrohet në ankandin e rregullt javor.

BANKA E SHQIPERISE

Operacioni Javor

Numri i Ankandit:	2017XXXX
Lloji i Marrëveshjes:	MARREVESHJE E ANASJELTE RIBLERJEJE / INJEKTIM LIKUIDITETI
Dita e Ankandit:	8/11/2017
Orari i Fundit për Dorëzimin e Kërkesave	14:00:00 PM
Data e Shlyerjes:	9/11/2017
Data e Riblerjes:	16/11/2017
Kohëzgjatja e Marrëveshjes (në ditë):	7
Lloji i Ankandit:	NORME_VARIABEL
Shuma e Shpallur (Vlera Standard):	19,600 mln
Norma Minimale e Kërkesave (norma bazë):	1.25%
Kërkesa Minimale/ dhe Shumëfisha të:	10 mln
Pjesëmarrja Maksimale:	70%
Informacion mbi Ankandin:	Sipas parashikimeve në datën 06/11/2017, niveli mesatar i faktorëve autonom për periudhën 07/11/2017 deri 15/11/2017 pritet të jetë 1,842.5 mln Lek. Për të njëjtën periudhë niveli mesatar i likuiditetit të pa-tregtueshëm pritet të jetë 265.6 mln Lek.

*Likuiditeti i konsideruar i pa-tregtueshëm, vjen si rezultat i segmentimit të tregut dhe limiteve të kreditimit që bankat kanë midis tyre

SI TË LLOGARISIM VLERËN STANDARDE TË LIKUIDITETIT TË OFRUAR (SHUMA E SHPALLUR)

Vlera standarde e likuiditetit të ofruar në operacionet e rregullta javore përkufizohet si injektimi i nevojshëm për t'u mundësuar bankave që në ditën përpara maturimit të këtij operacioni, të kenë plotësuar mesatarisht detyrimet për mbajtjen e rezervës.

Vlera standarde e likuiditetit të ofruar merr në konsideratë parashikimin e faktorëve autonomë dhe të gjitha mungesat apo tepricat e likuiditetit të akumuluar nga fillimi i periudhës. Këto diferenca mund të

lindin për shkak të devijimit nga parashikimi i faktorëve autonomë dhe për shkak të tepricës së patregtueshme më të lartë se niveli i parashikuar.

Vlera standarde e likuiditetit të ofruar mund të llogaritet duke përdorur formulën¹ e mëposhtme dhe parashikimin e publikuar nga Banka e Shqipërisë.

$$M_t^{bench} = \frac{1}{H_t - X_t} \left[\underbrace{D_t RR + ER - CA}_{\text{Mungesa/ Teprica e Akumuluar}} + \underbrace{H_t RR + ER - AF_t - NTL_t}_{\text{Ndryshimi në Nevojën për Likuiditet}} - \underbrace{H_t L + F - X_t * M^{mat}}_{\text{Likuiditeti i Tanimë i Financuar nga BSH}}$$

Mungesa/ Teprica e Akumuluar Ndryshimi në Nevojën për Likuiditet Likuiditeti i Tanimë i Financuar nga BSH

t = Dita e lajmërimit për zhvillimin e ankandit javor.

H_t = Numri i ditëve nga dita e lajmërimit (përfshirë), deri në ditën përpara maturimit të operacionit javor (përfshirë).

X_t = Numri i ditëve nga dita e lajmërimit (përfshirë), deri në ditën përpara shlyerjes së ankandit të ndërhyrjes javore.

D_t = Numri i ditëve nga dita e parë e periudhës (përfshirë), deri në ditën t-1 (përfshirë).

RR = Niveli mesatar i rezervave të detyruara për periudhën.

ER = Niveli i shënjestruar i rezervave të tepërta mesatare për periudhën në fjalë. BSH-ja, me anë të ndërhyrjeve të saj, synon një pozicion neutral të rezervave të tepërta deri në +100 milionë Lek. (Megjithatë, nëse do të ishte e nevojshme, ajo mund shënjestrojë një nivel tjetër.)

CA_t = Gjendja mesatare e llogarive të bankave duke filluar nga dita e parë e periudhës, deri në ditën t-1.

AF_t = Niveli mesatar i faktorëve autonomë të parashikuar për periudhën H_t (periudha e parashikuar).

NTL_t = Niveli mesatar i likuiditetit të supozuar i patregtueshëm për periudhën H_t (periudha e parashikuar).

L = Niveli mesatar i likuiditetit që është injektuar apo do të ofrohet me anë të operacioneve afatgjata, gjatë periudhës H_t .

F = Niveli mesatar i likuiditetit që supozohet se do të injektohet/tërhiqet nga tregu me anë të operacioneve rregulluese, gjatë periudhës H_t .

M^{Mat} = Vlera e ndërhyrjes javore paraardhëse që pritet të maturohet.

¹ Kjo formulë është një version i modifikuar i "Benchmark Allotment Formula", të përdorur nga BQE-ja.

PUBLIKIMI I INFORMACIONIT MBI GJENDJEN E LIKUIDITETIT

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë publikon çdo ditë informacionin mbi gjendjen e likuiditetit në ditën paraardhëse. Ky informacion do të përfshijë gjendjen totale të llogarive të bankave, rezervën e tepërt mesatare dhe nivelin e faktorëve autonomë. Në këtë tabelë publikohet edhe informacioni në lidhje me transaksionet në tregun ndërbankar.

Gjendja e Likuiditetit		
Periodha e Mbajtjes së Rezervës së Detyruar	24/10/2017 - 23/11/2017	
Rezerva e Detyruar për Periudhën		35,411.73
Shifrat më datë	6/11/2017	
Gjendja Mesatare e Llogarive Korrente		552.29
Gjendja e Llogarive Korrente		36,645.52
Përdorimi i Kredisë		-
Përdorimi i Depozitës		390.00
Niveli i Faktorëve Autonom		854.80
Niveli i Likuiditetit të Konsideruar I pa-tregtueshëm		-
Parashikimi I Likuiditetit	07/11/2017 - 15/11/2017	
Parashikimi i nivelit mesatar të faktorëve autonom		1,842.50
Parashikimi i nivelit të likuiditetit të pa-tregtueshëm		265.60

Duke qenë se faktorët autonomë janë jashtë kontrollit të drejtpërdrejtë të Bankës së Shqipërisë, ecuria e faktorëve autonomë mund të jetë e ndryshme, në krahasim me pritjet e publikuara. Këto pritje përfaqësojnë parashikimin më të mirë të Bankës së Shqipërisë, bazuar në mjetet e saj të parashikimit. Megjithatë, ajo nuk merr përsipër përgjegjësi për parashikimin e faktorëve të cilët janë jashtë kontrollit të saj.

Cilësia e parashikimit shqyrtohet vazhdimisht në Bankën e Shqipërisë. Bazuar në analiza të vazhdueshme të parashikimeve, Banka e Shqipërisë ka arritur në konkluzionin se parashikimet e saj janë të paanshme. Kjo do të thotë që me kalimin e kohës, devijimet pozitive barazojnë ato negative, duke e çuar devijimin mesatar afër nivelit zero.